

#19 ... 



Advocacy Center
for **Democratic Culture**

KORRIK
2022

BULETINI



office@acdc-kosovo.org
ngoacdc@gmail.com

SOCIAL MEDIA



Cika Jovina 3, North Mitrovica
Prote Mateje 48, Belgrade
Fehmi Agani 168/5, Prishtina

HYRJE

Janë nënshkruar marrëveshjet e granteve me të rinjtë në kuadër të projektit M4Y, është publikuar hulumtimi për pozitën e gruas, ka vazhduar fushata për diversitetin kulturor dhe një tjetër projekt është përfunduar me sukses.

Më shumë rreth lajmeve dhe aktiviteteve më të fundit në edicionin e ri të buletinit të OJQ ACDC



DISKUTIM PUBLIK DHE PREZANTIMI I HULUMTIMIT MBI POZITËN E GRUAS

Më 14 korrik, OJQ ACDC organizoi diskutim publik në kuadër të projektit "Gratë për gratë - të bashkuara në pushtet".

U prezantua hulumtimi që kishte për qëllim të shqyrtojë perceptimin e grave nga veriu i Kosovës, për pozitën e tyre në shoqëri dhe përfshirjen e tyre në jetën publike. Përveç rezultateve të hulumtimit, u diskutuan edhe rekomandimet që mund të ndikojnë në përmirësimin e pozitës së gruas, si dhe mënyrat për tejkalimin e stereotipeve dhe barrierave gjinore. Panelistët ishin Blagica Radovanović, OJQ Santa Marija, Biljana Miloshević Jarediq, Doktoreshë e Psikologjisë Klinike & Udhëheqëse e Departamentit të Psikologjisë në Fakultetin Filozofii dhe Ines Aljović Mihajlović, zyrtare e projektit në OJQ ACDC.





Hulumtimi është realizuar në kuadër të projektit “Gratë për Gratë – të bashkuara në pushtet”, i zbatuar nga Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike, dhe i mbështetur nga Reactor – Research in Action dhe partnerët e tyre përmes aksionit “Përparimi i barazisë gjinore përmes procesit të anëtarësimit në BE”.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi ishte që të analizojë pozitën e gruas në Kosovë, si dhe të paraqesë në detaje se sa sukses kemi arritur ne si shoqëri në tejkalimin e stereotipeve dhe barrierave gjinore.



MARRËVESHJET E NËNSHKRUARA TË GRANIT M4Y

Gjatë muajit korrik janë nënshkruar marrëveshje për grante me të rinjtë nga komunat e Zveçanit, Ranillugut, Vushtrrisë dhe Skenderajt. Në periudhën e ardhshme, me ndihmën e mjeteve të marra përmes projektit "Komunat për të rinj", gjithsej 26 ekipe do të kenë mundësinë të përmirësojnë komunat e tyre përkatëse përmes realizimit të ideve të tyre dhe në këtë mënyrë të përmirësojnë pozitën e të rinjve. Rezultatet e projekteve do të monitorohen dhe prezantohen në periudhën e ardhshme.




Projekti "Komunat për Rini" mbështetet nga Fondi Japonez për Zhvillim Social, Banka Botërore, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe zbatohet nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF) dhe Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC).



NGJARJA PËRMBYLLËSE E PROJEKTIT TË MBËSHTETUR NGA READ

Konferenca për diversitetin kulturor u mbajt më 26 korrik në ambientet e Qendrës Kulturore Private "Aquarius" në Mitrovicën e Veriut. Konferenca trajtoi diversitetin kulturor dhe dialogun ndërkulturor në shoqërinë kosovare. Gjithashtu, gjatë konferencës, OJQ ACDC ka prezantuar aktivitetet e projektit në kuadër të projektit Mbështetja e Shkrimtarëve të Rinj në Dialogun Ndërkulturor dhe Promovimi i Diversitetit Kulturor. Folësit ishin Miljana Dungjerin, Qendra Private Kulturore "Aquarius", Ilda Krama, muzikante dhe arkitekthe, dhe Lulzim Hakaj, bashkëthemelues i Reconciliation Empowering Communities – OJQ REC.




Në muajin Korrik, OJQ ACDC vazhdoi me kampanjën publike për të ngritur ndërgjegjësimin public dhe të promovojë ndërgjegjësimin ndërkulturor, mirëkuptimin dhe respektin e diversitetit kulturor dhe shprehjet kulturore. ACDC kontaktoi me individë të shquar me prejardhje të ndryshme nga Kosova, të cilët dhanë mesazhe specifike mbi rëndësinë e diversitetit kulturor dhe marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve.



Ines Aljovic Mihajlovic, zyrtare e programit të OJQ ACDC, mori pjesë në konferencën për shtyp të Komitetit të Juristëve për të Drejtat e Njeriut (YUCOM) që u mbajt në Media Center në Beograd.


Në konferencë, gjetjet nga Raporti nr. 3 për zbatimin dhe efektet e Marrëveshjes për Drejtësi "Integrimi i gjyqësorit serb në sistemin gjyqësor të Kosovës në kuadër të integrimit evropian dhe dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës".

 [LINK](#)

 [Medija Centar](#)

 [NewsMax Adria](#)

 [Nova.Rs](#)



Për më tepër, Ines shkroi një tekst të quajtur "Të ballafaqohesh me të kaluarën - një rrugë e gjatë dhe me gjemba", e cila u botua në buletin e Grupit të Punës të Konventës Kombëtare për Bashkimin Evropian për Kapitullin 35. Në tekstin e saj, Ines trajtoi problemin të personave të zhdukur nga Kosova.



Aleksandar Rapajiq, drejtor i programit në OJQ ACDC - Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike ishte panelist në ngjarjen e organizuar nga OJQ AKTIV.

Gjatë ngjarjes u prezantuan gjetjet e hulumtimit "Perspektiva e regjistrimit të komunitetit serb të Kosovës".



INFORMATIVE VIDEO SPOT ON THE WORK OF ACA

Në kuadër të projektit "Rritja e reagimit institucional ndaj korrupsionit në veri të Kosovës", është publikuar video informuese për Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit.

Videoja informuese ofron informacione për kompetencat dhe fushëveprimin e punës së Agjencisë dhe mund ta shikoni në linkun e mëposhtëm.

[LINK](#) 



PARAQITJET MEDIALE

Në kuadër të projektit Promovimi i dialogut ndëretnik në pushtetin lokal, i financuar nga National Endowment for Democracy, është transmetuar emisioni televiziv me titull "Fuqizimi i mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të pakicave". Të ftuar ishin z. Skender Sadiku, nënkryetar i Kuvendit të Mitrovicës së Veriut pranë komuniteteve dhe Aleksandar Rapajiq, të cilët diskutuan për problemet me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komuniteteve joshumicë në komunën e Mitrovicës së Veriut.

[LINK](#) 

Në kuadër të projektit "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në Kosovë - komunitetet me shumicë serbe" financuar nga Byroja Ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit - INL, u transmetua emision televiziv në të cilin të ftuar ishin z. Dushan Radaković, drejtor ekzekutiv i OJQ ACDC dhe Zyrtarja e Projektit të OJQ ACDC, Znj. Ines Aljović Mihajlović. U diskutua rëndësia e praktikës profesionale për avokatët e rinj në sistemin e Kosovës, vështirësitë dhe pengesat me të cilat përballen avokatët e rinj, si dhe verifikimi i diplomave.

[LINK](#) 